



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 02.05.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 19.04.2023.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 19.04.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1- Sa është numri i kontratave të lidhura nga Bashkia Himarë për dhëniën me qira të tokave të administruara prej saj me kompanitë private të cilat kanë fituar licensat për ndërtimin, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotovoltaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Himarë.

-Bashkia Himarë ka lidhur në vitin 2020 4 kontrata, në vitin 2022 4 kontrata dhe në vitin 2023 1 kontratë.

2- Një kopje të kontratave të lidhura nga Bashkia Himarë për dhëniën me qira të tokave të administruara prej saj me kompanitë private të cilat kanë fituar licensat për ndërtimin, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotovoltaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Himarë.

-Bashkëngjitur ju dërgojmë kopje të kontratave.

3- Një kopje të kërkesave që janë depozituar në Bashkinë Himarë për marrjen e tokave me qira nga shoqëritë të cilat kërkojnë të zhvillojnë projekte për ndërtimet e centraleve fotovoltaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Himarë.

-Bashkëngjitur ju dërgojmë kopje të kërkesave.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!